



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSSHME

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Akademia e Sigurisë

Tiranë, më 5. 2025

**THIRRJE PËR BOTIM ARTIKUJSH NË REVISTËN SHKENCORE
"POLICIMI DHE SIGURIA", NR. 34**

Revista shkencore "Policimi dhe siguria", me ISSN 2413-1334, është botim periodik i Akademisë së Sigurisë, që shërben për publikimin dhe shpërndarjen e rezultateve të veprimtarisë kërkimore shkencore të Akademisë së Sigurisë në fushën e policimit dhe sigurisë. Qëllimi i botimit të revistës "Policimi dhe siguria", është ofrimi i një platforme studimore për studiues të ndryshëm të organizatës së Policisë së Shtetit e më gjerë, ku të shkëmbehen mendime në lidhje me policimin, sigurinë publike e çështje të tjera që kanë lidhje me to.

Revistën e drejton kryetari i bordit editorial të saj. Për ndjekjen e realizimit të botimit përgjigjet sektori i botimeve të Qendrës së Kërkimore Shkencore dhe Projekteve, konkretisht redaktori shkencor përgjegjës i revistës.

Revista fton dhe është e hapur edhe për bashkëpunime e kontribute të kërkimit shkencor prej të tretëve. Artikujt të cilët përmbajnë plagjiaturë, përdorimin e ideve dhe fjalëve nga publikimet e një personi tjetër pa dhënë referencën përkatëse, nuk publikohen dhe autori mban përgjegjësi. Artikulli i dorëzuar për botim, pas vlerësimit pozitiv dhe miratimit të bordit editorial, përfshihet për botim në numrin e radhës së revistës. Të gjithë artikujt duhet t'i përmbahen standardeve akademike të kërkuara nga revista "Policimi dhe siguria" dhe krahas kësaj, prej lexuesve duhen respektuar edhe afatet kohore.

Abstraktet e artikujve që synojnë të botohen në revistën "Policimi dhe siguria" nr. 34, duhet të dorëzohen deri në datën 31 maj 2025. Pas miratimit të tematikës, punimet për revistën "Policimi dhe siguria" nr. 34, duhet të dorëzohen deri në datën 30 qershor 2025. Është shumë e rëndësishme që punimet t'i përmbahen standardeve teknike të së shkruarit akademik dhe të vendosjes së burimeve.

Artikujt rekomandohet të përfshijnë një nga tematikat e mëposhtme dhe jo vetëm:

- rendi dhe siguria publike,
- siguria kombëtare,
- parandalimi i kultivimit të lëndëve narkotike,
- nga kriminologjia,
- nga kriminalistika,
- nga mjekësia ligjore,
- siguria kibernetike,
- policimi në komunitet,
- menaxhimi policor,
- arsimimi dhe trajnimi policor
- Parandalimi i radikalizmit dhe luftën kundër terrorizmit
- Parandalimi dhe luftën kundër krimi i organizuar, etj.

Revista "Policimi dhe siguria" publikohet në versionin fizik dhe mund të gjendet edhe në atë elektronik në faqen tonë të internetit. Revista publikon studime origjinale, punime konceptore, analiza dhe skenarë të trajtuar sipas natyrës studimore, kërkime empirike, studime teknike në lidhje me fusha të ndryshme që ndërthuren me policimin, analizë librash, etj.

Revista "Policimi dhe siguria" ju fton që të bëheni pjesë e saj me punimet tuaja, të cilat pas pranimit do të botohen në numrin 34.

Dërgojeni abstraktin dhe artikullin tuaj në adresën:
kerkimishkencor.as@gmail.com

Akademia e Sigurisë zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Policinë e Shtetit dhe atë mbi arsimin e lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike. Pikëpamjet e shprehura në revistën "Policimi dhe siguria", janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Akademisë së Sigurisë dhe të Policisë së Shtetit. Autorët e publikimeve në revistën "Policimi dhe siguria" gëzojnë liri të plotë akademike, me kushtin e vetëm që kur shkruajnë, ata të zbatojnë të gjithë legjislacionin përkatës si të komunikimit edhe atë profesional, i cili nuk cenon të drejtat e ndryshme.

STANDARDET DHE RREGULLAT E PUNIMIT PËR REVISTËN SHKENCORE
"POLICIMI DHE SIGURIA", ISSN 2413-1334

Mbi standardet dhe strukturën e punimit shkencor:

Punimi shkencor duhet të përbëhet nga disa pjesë kryesore:

1. *Titulli i artikullit.*
2. *Abstrakti.* Përmbledhja në shqip dhe anglisht (nga 200 deri në 400 fjalë).
3. *Fjalëkyçe* (3–5 fjalë)
4. *Hyrja*

Në hyrje duhet të prezantohet përmbajtja e punimit dhe qëllimi i tij. Gjithashtu duhet të tregohet metodologjia që do të përdoret, burimet dhe ku qëndron rëndësia e punimit. Madhësia e lejuar 1- 3 faqe A4.

5. *Pjesa kryesore. Çështjet.*

Punimi mund të ndahet në disa çështje në varësi të temës së zgjedhur. Çështjet duhen të jenë në shërbim të temës dhe duhet të kenë lidhje me njëra-tjetrën.

6. *Përfundime*

Në pjesën e përfundimeve duhet të shkruhet rreth temës së zgjedhur dhe çfarë është arritur të provohet dhe cilët përfundime veçohen. Përfundimet i japin përgjigje problemeve të parashtruara në hyrje dhe të diskutuara në pjesën kryesore. Madhësia e lejuar deri në 1-3 faqe A4.

7. *Bibliografia*

Në fund të temës duhet të përfshihen një bibliografi e plotë e materialeve që janë përdorur në citime ose referenca të vendosura sipas rendit alfabetik. Mund të përdoret renditja e mëposhtme:

- libra;
- artikujt (në revista dhe në përmbledhje);
- artikuj nga interneti;
- lista e rasteve praktike (kazuseve);
- burime të përgjithshme interneti;
- dokumente të ndryshme ligjore.

Rregullat për paraqitjen e punimit dhe për literaturën:

- Punimi duhet të respektojë kërkesat e formatit. Nëse punimi nuk prezantohet sipas formatit të kërkuar, ai nuk pranohet deri sa të plotësohen të gjitha kërkesat e formatit.
- Përmbledhja në shqip dhe në anglisht [abstrakti]. Secili variant duhet të përmbajë 200 - 400 fjalë duke u përdorur masa 12-she e shkronjës. Ky element duhet t'u mundësoje

lexuesve vendas dhe të huaj të kuptojnë sesi është trajtuar çështja e marrë në studim. Përmbledhja në anglisht është një kërkesë e domosdoshme e standardeve ndërkombëtare.

- Gjatësia e punimit. Punimi duhet të përmbajë jo më pak se 5000 fjalë (rreth 10 faqe kompjuterike a4). Në këtë numër fjalësh përfshihet përmbajtja, referencat në fund të faqes, por nuk përfshihet bibliografia.

- Cilësia e shtypjes. Teksti duhet të shtypet me hapësirë 1.15 ndërmjet rreshtave. Hapësira 1.15 do të përdoret edhe për përgatitjen e tabelave të gjata, të ekstrakteve, të shënimeve, të shpjegimeve të gjata dhe të listës së bibliografisë. Lloji i vetëm i shkrimit të përdorur duhet të jetë "Times New Roman". Madhësia e shkronjës duhet të jetë 12-she.

- Margjinat (largësia e tekstit nga anët e letrës)- Margjinat për të gjithë tekstin do të jenë:

Margjina e sipërme 1 ose 2.54 Cm.

Margjina e poshtme 1 ose 2.54 Cm.

Margjina e majtë 1.25 ose 3.17 Cm.

Margjina e djathtë 1.25 ose 3.17 Cm.

(kryesisht janë ato margjina që programi "Microsoft Word" i përdor automatikisht)

- Numrat e faqeve. Të gjitha numrat e faqeve duhet të vendosen poshtë dhe në mes të faqes.

- Tabelat. Tabelat është mirë të përfshihen në tekst. Tabelat duhet të vendosen në qendër të faqes, brenda margjinave të caktuara. Çdo tabelë i duhet vendosur një numër referimi me numër arab. Numri i tabelës duhet të ndjekë numrin e kapitullit të cilit i përket. Fjala "tabelë", numri i tabelës dhe legjenda duhet të vendosen në krye të tabelës. Nëse tabela vazhdon në faqen tjetër legjenda nuk përsëritet. Nëse një tabelë përmban citate, referencat duhet të theksohen.

- Diagramet. Nëse diagramet paraqiten si fotografi, duhet të vendosen në faqen përkatëse, ilustrimet ose grafikët nuk e ndjekin tekstin ose tabelën gjithmonë. Fjala "figurë", numri i diagramit me numër arab dhe shpjegimet duhet të vendosen poshtë diagramesh. Përgjithësisht një diagram nuk duhet të kalojë një faqe. Nëse diagrami vazhdon në faqen tjetër, duhet të ndiqet rregulli për tabelat. Si edhe tabelat, diagramet duhet të mblidhen bashkë dhe t'u vihen numra pasues. Fotografitë që janë më të vogla se një faqe duhet të vendosen në faqen përkatëse.

Referencat:

- Punimi për botim në revistën "Policimi dhe siguria" duhet të përmbajë referencat të mjaftueshme dhe të sakta. Ato duhet të jetë të përfshira në punim, sipas sistemit të referencave *Chicago Style* (footnote).

Referencat duhet të shkruhen sipas shembujve si vijojnë:

Referencat (footnote) dhe bibliografia: shembuj citimesh:

Shembujt e mëposhtëm ilustrojnë përdorimin e citimeve në formë fusnotash dhe si bibliografi (në fund të shkrimit). Në fillim jepet shembulli i referencës si fusnotë, i vendosur në fund të faqes, i cili ndiqet nga shembulli i citimit të shkurtuar kur citohet i njëjti burim dhe në fund jepet shembulli i bibliografisë që vendoset në fund të punimit. Këto referenca janë sipas mënyrës së citimit të "Stilit Çikago" (The Chicago Style). *Duhet të ruhet vendosja e germës italike siç jepet në shembuj!*

Libra:**Me një autor:**

1. Michael Pollan, *The Omnivore's Dilemma: A Natural History of Four Meals* (New York: Penguin, 2006), 99–100.
 2. Pollan, *Omnivore's Dilemma*, 3.
- Pollan, Michael. *The Omnivore's Dilemma: A Natural History of Four Meals*. New York: Penguin, 2006.

Dy ose më shumë autorë:

1. Geoffrey C. Ward dhe Ken Burns, *The War: An Intimate History, 1941–1945* (New York: Knopf, 2007), 52.
 2. Ward and Burns, *War*, 59–61.
- Ward, Geoffrey C., dhe Ken Burns. *The War: An Intimate History, 1941–1945*. New York: Knopf, 2007.

Për katër ose më shumë autorë, mund të vendosen të gjithë autorët rresht në bibliografi; në referencën në fund të faqes vendos vetëm autorin e parë, ndjekur nga ky term: *et al.* ("dhe të tjerë"):

1. Dana Barnes et al., *Plastics: Essays on American Corporate Ascendancy in the 1960s* . .
2. Barnes et al., *Plastics* . . .

Redaktor, përkthyes, ose përgatitje – në vend të autorit:

1. Richmond Lattimore, përk., *The Iliad of Homer* (Chicago: University of Chicago Press, 1951), 91–92.
2. Lattimore, *Iliad*, 24.

Lattimore, Richmond, përk. *The Iliad of Homer*. Chicago: University of Chicago Press, 1951.

Kapitull ose pjesë të tjera të librit:

1. John D. Kelly, "Seeing Red: Mao Fetishism, Pax Americana, and the Moral Economy of War," në *Anthropology and Global Counterinsurgency*, red. John D. Kelly et al. (Chicago: University of Chicago Press, 2010), 77.
2. Kelly, "Seeing Red," 81-82.

Kelly, John D. "Seeing Red: Mao Fetishism, Pax Americana, and the Moral Economy of War." Në *Anthropology and Global Counterinsurgency*, redaktuar nga John D. Kelly, Beatrice Jauregui, Sean T. Mitchell, and Jeremy Walton, 67-83. Chicago: University of Chicago Press, 2010.

Artikulli i një reviste shkencore:

Në këto raste, në referencë, vendoset faqja e referuar (nëse ka një). Në bibliografi, vendos faqet nga e para e deri ku mbaron artikulli në revistë.

1. Joshua I. Weinstein, "The Market in Plato's Republic," *Classical Philology* 104 (2009): 440.
 2. Weinstein, "Plato's Republic," 452-53.
- Weinstein, Joshua I. "The Market in Plato's Republic." *Classical Philology* 104 (2009): 439-58.

Burime të përgjithshme interneti:

Uebi i Këshillit të Evropës. Marrë nga <http://ëëë.cm.coe.int>,

Në rastet kur i referoheni të njëjtit burim të përdorur në referencën paraardhëse mund të shkruani vetëm: *po aty* (*Ibid* në anglisht/latinisht) Fq. 10 (faqe nr. 10)

Kur referohet vetëm ideja... referenca vendoset në fund të fjalisë. Kur citohet në origjinal, pjesa e cituar futet në thonjëza. Citimi nuk mund të kalojë pesë rreshta me hapësirë normale dhe madhësi 10 pt.

Mbi etikën e kërkimit:

- Plagjiatura përfshin përdorimin e ideve dhe të fjalëve nga publikimet e një personi tjetër pa dhënë referencën përkatëse. Kërkohet që të shënohet referenca përkatëse nëse përdoren idetë e të tjerëve.
- Përdorimi i ideve ose punës së të tjerëve duhet të evidencohet individualisht në tekst ose secili punim i përdorur duhet të shënohet në listën e referencave ose në bibliografi.

- Të gjitha citimet nga punimet e të tjerëve duhet të vendosen në thonjëza dhe të shënohet burimi.
- Nëse pasazhet e marra nga të tjerët janë më të gjata se 5 radhë nuk futen në thonjëza, por shënohet referenca për to.
- Sqarimet e mundshme të kandidatit duhen futur në kllapa katrore.
- Nëse burimi origjinal nuk gjendet dot, por ai është përmendur në një dokument tjetër, atëherë duhet të jepen të dy dokumentet burimi origjinal dhe burimi dytësor.

Vlerësimi shkencor i punimit:

Punimi dorëzohet në redaksinë e revistës. Pas dorëzimit të artikullit, redaktori shkencor i revistës, ja kalon për vlerësim shkencor Bordit të revistës i cili vendos për botimin, plotësimin ose refuzimin e arsyetuar të punimit.

Botimi i artikullit

Pas kësaj artikulli i miratuar nga "Bordit editorial" përfshihet për botim në numrin e radhës së revistës. Pas botimit të revistës, një kopje fizike e saj i rezervohet autorit të shkrimit.

Duke Ju falënderuar!

Rectori
Prof. Dr. Ilirjan Mandra

